

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 5 të Ligjit për gjykatat, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 28.12.2021, miratoi:

PROGRAMIN E PUNËS të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022

Në pajtim me nenin 92 paragrafi (2) të Ligjit për gjykatat dhe nenin 51 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Seanca e gjyqtarëve miraton Programin e punës të Gjykatës me propozim të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencën e saj kushtetuese dhe ligjore si gjykatë më e lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut e realizon në pajtim me Kushtetutën, ligjet, Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në pajtim me Ligjin, Rregulloren gjyqësore dhe akte të tjera nënligjore.

Me Programin e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022 definohe punët dhe detyrat punuese nga fushëveprimi i punës së Gjykatës në procesin e veprimit të drejtë me qëllim që të sigurohet:

- zbatimi i paanshëm i drejtësisë pavarësisht nga pozita dhe cilësia e palëve;
- mbrojtja, respektimi dhe përparimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- sigurimi i barazisë, barabarësisë, mos diskriminimit për çfarëdo baze;
- vendosja cilësore dhe në kohë e lëndëve në kompetencë të Gjykatës;
- ofrimi i sigurisë juridike përmes unifikimit të praktikës gjyqësore në bazë të sundimit të drejtësisë;
- realizimi i principeve për gjykim në afat të arsyeshëm dhe sigurimi i kushteve për qasjen më të shpejtë në drejtësi;
- transparenca dhe publiku në punën e Gjykatës, për sigurimin e informimit në kohë të palëve dhe publikut për vendimet e Gjykatës;

- zbatimi konsekuent i ligjeve proceduese dhe materiale dhe akteve të tyre nënligjore; Ligjit për gjykatat, Ligjit për shërbimin gjyqësor dhe Rregullores së

punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- harmonizimi i praktikës gjyqësore dhe sigurimi i barazisë në zbatimin e ligjeve nga gjykatat;
- respektimi dhe veprimi i vendimeve definitive dhe përmbaruese të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshje të tjera të ratifikuara në pajtim me Ligjin;

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjyqtarët dhe të punësuarit në Gjykatën janë të obliguar të sigurojnë realizimin e Programit të miratuar për periudhën e shënuar.

Detyrat e programit

Administrata gjyqësore

Kryetari i Gjykatës do t'i kryejë punët nga fushëveprimi i administratës gjyqësore, do të organizojë punën, do të menaxhojë dhe udhëheq me Gjykatën.

Kryetari i Gjykatës do të prezantojë Gjykatën dhe do të ndërmerr masa për kryerjen me rregull dhe në kohë të punëve, do të sigurojë zbatimin e Rregullores gjyqësore, do të miratojë Orarin e punës të Gjykatës, do të veprojë për parashtresat dhe ankesat e palëve dhe organeve tjera, për kërkesat e vendosjes me prioritet të lëndëve, për kërkesat për përjashtim, të parashtruara nga gjyqtarët dhe nga palët dhe do të ndërmerr veprime të tjera për të cilat është kompetent sipas Ligjit, Rregullores gjyqësore dhe Rregullores të punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për kryerjen e punëve në mënyrë efikase, në kohë dhe në rregull të administratës gjyqësore, Kryetari i Gjykatës mund t'ia besojë detyrat e punës zëvendësit të tij ose ndonjë gjyqtari tjetër, gjyqtarit kryetar të sektorit, administratorit gjyqësor ose ndonjë nëpunësi tjetër dhe sipas nevojës do të organizojë edhe ekipin e tij për punët e kabinetit.

Në rast të pengesës ose mungesës Kryetarit e Gjykatës do ta zëvendësojë zëvendësi i kryetarit të Gjykatës.

Administratori gjyqësor do të menaxhojë me shërbimin gjyqësor, do të jetë përgjegjës për realizimin dhe kryerjen e punëve profesionale dhe administrativo – teknike të Gjykatës, do të bashkëpunojë dhe do t'i ndihmojë Kryetarit të Gjykatës në kryerjen e punëve të administratës gjyqësore, do të ndjek kryerjen e punëve të punësuarve në shërbimin gjyqësor, zbatimin e Rregullores gjyqësore nga të punësuarit e Gjykatës, përveç policisë gjyqësore.

Kryetari i Gjykatës, rregullisht thërret Seancë të gjyqtarëve për shqyrtimin e realizimit të Programit të punës së Gjykatës dhe shqyrtimin, analizën dhe ndërmarrjen e masave për raportet e punës së Gjykatës, harmonizimin e punës së Sektorëve, dhënien e mendimit nga kompetenca e Seancës së gjyqtarëve dhe për çështje të tjera nga puna e Gjykatës.

Organizimi i punës

Kompetencën kushtetuese dhe ligjore për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe sigurimin në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e realizon përmes miratimit të qëndrimeve juridike dhe mendimeve juridike parimore, mendimeve juridike dhe konkluzioneve të miratuara në:

- Seancën e përgjithshme,
- Seancën e gjyqtarëve dhe në
- Seancën e sektorit.

Në pajtim me nenin 66 paragrafi (1) dhe (2) nga Rregullorja gjyqësore në realizimin e kompetencës vendore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas llojit të lëndëve dhe vëllimit të punës, Gjykata e realizon në kuadër të:

- Sektorit të veprave penale,
- Sektorit të veprave civile,
- Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm dhe
- Këshillave të specializuar.

Veprimi me lëndët

Qëllimi themelor gjatë veprimit të lëndëve është që të sigurojë veprim profesional, të paanshëm, ligjor dhe në kohë, të lëndëve duke respektuar afatet ligjore dhe afatet për gjykim në afat të arsyeshëm në pajtim me dispozitat nga Rregullorja gjyqësore dhe Ligji për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykatat, në çdo fazë të procedurës. Regjistrimi, shpërndarja, veprimi, vendimmarrja, publikimi, përpilimi i vendimeve, dorëzimi i vendimeve, anonimizimi i vendimeve të WEB faqes së Gjykatës, do të bëhet me zbatimin e plotë dhe ekskluziv të sistemit kompjuterik të automatizuar për udhëheqjen me lëndët gjyqësore (AKMIS).

Regjistrimi i lëndëve do të bëhet sipas kohës së pranimit, ndërsa shpërndarja e lëndëve nëpër gjyqtarët do të bëhet me shpërndarjen automatike në AKMIS. Rishpërndarja automatike e lëndëve, do të bëhet vetëm në situata të përcaktuara me Rregulloren gjyqësore dhe në pajtim me Orarin vjetor të punës së Gjykatës, por edhe në ato raste rishpërndarja e lëndëve do të bëhet ekskluzivisht me vendim të arsyetuar nga Kryetari i Gjykatës përmes modulit përkatës në AKMIS, për sigurimin e mbrojtjes së parimit të shpërndarjes automatike dhe përfshirjen e faktorit njeri gjatë ndarjes së lëndëve në punë gjyqtarëve.

Gjyqtarët janë të obliguar të japin prioritetin në vendosjen e lëndëve, të cilat me Ligj është përcaktuar se janë urgjente dhe për të cilat është dhënë prioritet nga Kryetari i Gjykatës.

Spektori i veprave penale

Në Sektorin e veprave penale do të veprojnë 5 (pesë) gjyqtarë.

Në këtë Sektor gjyqtarët veprojnë në:

- këshillin prej pesë gjyqtarëve dhe këshillat prej tre gjyqtarëve për të gjitha llojet e lëndëve (VKZH1 – 5, VKZH2 – 5, KVP.KOK1.KVP - 3, KVP.KOK2.KVP – 5, KVP1 – 3, KVP2 – 5, VUK – 3-5, KZZ – 5, KR – 3).
- këshillin prej pesë gjyqtarëve të formuar sipas Ligjit për drejtësi për fëmijët (LDF),
- gjyqtar individ dhe në këshillin prej tre gjyqtarëve sipas Ligjit për ndjekjen e komunikimeve.

Kryetari i Sektorit, Kryetari i këshillave, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit, mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe të arsyetuara dhe për shkak të numrit të rritur të lëndëve.

Për gjendjen e Sektorit, Kryetari i Sektorit, rregullisht do të informojë Kryetarin e Gjykatës, përveç për lëndët për të cilat procedura zgjat më gjatë dhe e tejkalon afatin e arsyeshem për veprim.

Gjatë vendosjes së lëndëve penale ku është konstatuar parashkrimi i ndjekjes penale duhet që të vërehen shkaqet e të njëjtës, për shkak të përpilimit të raporteve me atë informacion.

Gjatë vendosjes së të gjitha lëndëve penale, të vërehen çështjet lidhur me çështjet juridike për shkak të miratimit të mendimeve juridike, konkluzioneve, përpilimit të sentencave dhe të njëjtat të publikohen në WEB faqen e Gjykatës.

Kryetari i Sektorit, mendimet juridike dhe konkluzionet e Sektorit i dorëzon në Sektorin e praktikës gjyqësore, si dhe propozimin me material të përgatitur në Seancën e përgjithshme për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

Spektori i veprave civile

Në Sektorin e veprave civile, do të veprojnë 10 (dhjetë) gjyqtarë dhe Kryetari i Gjykatës.

Në këtë Sektor, gjyqtarët veprojnë në këshillat prej pesë gjyqtarëve dhe këshillat prej tre gjyqtarëve për të gjitha llojet e lëndëve të regjistruara në regjistrat: Rev1, Rev2, Rev3 dhe R.

Kryetari i Sektorit, Kryetari i këshillave, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit, mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe të arsyetuara dhe për shkak të numrit të rritur të lëndëve.

Gjatë vendosjes së të gjitha lëndëve civile të vërehen çështjet lidhur me çështje juridike për shkak të miratimit të mendimeve juridike, konkluzioneve, përpilimin e sentencave dhe të njëjtat të publikohen në WEB – faqen e Gjykatës.

Kryetari i Sektorit, mendimet juridike dhe konkluzionet e Sektorit i dorëzon në Sektorin e praktikës gjyqësore, si dhe propozimin me materialin e përgatitur në Seancën e përgjithshme për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore..

Sektor i për gjykim në afat të arsyeshëm

Në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, do të veprojnë 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Në këtë Sektor, në shkallën e parë – për kërkesat e palëve për gjykim në afat të arsyeshëm, gjyqtarët do të veprojnë në këshillat prej tre gjyqtarëve për të gjitha llojet e lëndëve të regjistruara në Regjistrat: PSRRK, PSRRG dhe PSRRU.

Në këtë Sektor, në shkallën e dytë gjyqtarët do të veprojnë në këshillin prej pesë gjyqtarëve për lëndët e regjistruar në PSRRZH.

Kryetari i Sektorit, Kryetari i këshillave, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe të arsyetuara dhe për shkak të numrit të rritur të lëndëve.

Për gjendjen e Sektorit, Kryetari i Sektorit rregullisht do të njoftojë Kryetarin e Gjykatës, veçanërisht për lëndët për të cilat procedura zgjat më shumë dhe e tejkalon afatin e arsyeshëm të procedimit.

Gjatë vendosjes së lëndëve, të vërehen çështjet lidhur me çështjet juridike për shkak të miratimit të mendimeve juridike, konkluzioneve, përpilimin e sentencave dhe të njëjtat të publikohen në WEB faqen e Gjykatës.

Kryetari i Sektorit, mendimet juridike dhe konkluzionet e Sektorit i dorëzon në Sektorin e praktikës gjyqësore, si dhe propozimin me materialin e përgatitur në Seancën e përgjithshme për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

Sektor i praktikës gjyqësore

Në Sektorin e praktikës gjyqësore, me Orarin vjetor të punës do të sistemohen Kryetarët e Sektorëve dhe këshilltarët gjyqësor, të cilët i realizojnë obligimet e punës të sekretarëve të Sektorëve.

Sektor i praktikës gjyqësore, e harmonizon punën e Sektorëve dhe Seancës së përgjithshme në realizimin e detyrave që kanë të bëjnë me evidencën, studimin e praktikës gjyqësore në pajtim me nenin 72 nga Rregullorja gjyqësore.

Duke marrë parasysh unifikimin e praktikës gjyqësore si një nga funksionet më të rëndësishme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i

domosdoshëm përforcimi i këtij Sektori, si me resurse njerëzore ashtu edhe me resurse informatike, në mënyrë që do të mundësohet seleksionimi më i lehtë, kategorizimi dhe sistematizimi i vendimeve të Gjykatës, ndërsa baza për kërkim do të jetë më e kapshme nga shfrytëzuesit.

Këshillat e specializuar

Në këshillat e specializuar për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtje për shkak të veprimit të kundërligjshëm (USPIZH), do të veprojnë 6 (gjashtë) gjyqtar në këshillat prej tre gjyqtarëve.

Në pajtim me nenin 42 paragrafi (5) të Ligjit për Këshillin gjyqësor, do të veprojnë këshill prej pesë gjyqtarëve, që do të vendos për ankesë të një kandidati që nuk është zgjedhur gjyqtar, përkatësisht Kryetar i Gjykatës, të regjistruar në USSZHI.

Kryetari i këshillit, gjyqtarët anëtarë të këshillit dhe zëvendësit e tyre sistemohen me Orarin vjetor të punës.

Gjatë vitit, mund të bëhet ndryshimi i Orarit vjetor të punës me vendim të arsyetuar të Kryetarit të Gjykatës për shkaqe të arsyetuara dhe për shkak të vëllimit të zmadhuar të punës.

Resurse njerëzore

Me vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është konstatuar se në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, funksionin e gjykatësit do ta ushtrojnë 28 gjyqtarë. Deri në fund të vitit 2021 në Gjykatë, funksionin e gjykatësit e kryejnë 17 gjyqtarë dhe Kryetari i Gjykatës.

Duke marrë parasysh numrin e gjyqtarëve dhe numrin e vendeve të paplotësuara të gjyqtarëve nga njëra anë, ndërsa në anën tjetër llojin dhe vëllimin e lëndëve, si dhe kompetencën ligjore dhe kushtetuese të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si gjykatë më e lartë në shtetin, realisht mund të pritët se gjyqtarët do të përballën me vështirësi në realizimin e funksionit të gjyqtarit në aspektin e efikasitetit dhe në shmangien e ndërprerjes së lëndëve, në qoftë se gjatë vitit nuk plotësohen vendet për gjykatës, si dhe vendet e zbrazura të nëpunësve gjyqësor.

Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zotohet për njoftimin në kohë të publikut për procedurat gjyqësore, për të cilat është evident interesi publik dhe prania e medimeve. Vetëm me hapjen, transparencën dhe dhënien në kohë të informacioneve relevante për Gjykatën në procedurat individuale mund të mbrohet dhe të rruhet reputacioni i Gjykatës dhe të rritet besimi i publikut ndaj Gjykatës. Në anën tjetër, informimi në kohë dhe në rregull të publikut do të pengojë publikimin e informacioneve të

pasakta nga mediumet, që mund të kenë ndikim të dëmshëm si për Gjykatën, ashtu edhe për palët dhe interesin e tyre.

Për sigurimin e kësaj detyre të programit në Gjykatën rregullisht do të publikohen njoftime në WEB faqen e Gjykatës, ndërsa përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun do të mundësohet qasja për personat e interesuar për informacionet aktuale dhe procedurat që zhvillohen në Gjykatë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për qarkullimin e lëndëve në gjykatat.

Në WEB faqen e Gjykatës, rregullisht do të publikohet rendi ditor nga puna e Seancës së përgjithshme, qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore dhe konkluzionet e miratuara dhe të gjitha informacionet tjera lidhur me punën e Seancës së përgjithshme, si dhe rendi ditor, mendime juridike dhe konkluzione nga Seancat e Sektorëve.

Në Gjykatë do të caktohet person zyrtar për ndërmjetësimin me informacione të karakterit publik, që do të veprojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për qasje të lirë në informacionet.

Vendimet e miratuara do të anonimizohen në pajtim me Ligjin për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykatat dhe të njëjtat do të publikohen në WEB faqen e Gjykatës, në mënyrë që mundësohet qasja e publikut në punën e Gjykatës.

Çështja financiare

Në kuadër të buxhetit të miratuar nga Këshilli i buxhetit gjyqësor për vitin rrjedhës, do të sigurohet zbatimi në kohë i procedurave të prokurimit publik në pajtim me dispozitat e Ligjit për prokurime publike, ndërsa përmes menaxhimit me mjetet financiare do të këmbëngulet që detyrimet të paguhen në kohë në vitin aktual.

Qëllimet e programit

Për realizimin me sukses të këtij programi është i domosdoshëm pro aktiviteti dhe angazhimi i gjyqtarëve dhe të gjithë të punësuarve në Gjykatë, për arritjen e qëllimeve të miratuara të programit dhe detyrave të parashtruara.

Mungesa e kuadrit aktiv të gjyqtarëve nga 28 gjyqtarë të paraparë me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, funksioni i gjyqtarit me vetëm 17 gjyqtarë krijon tension të madh në efikasitetin dhe cilësinë e funksionimit të institucionit.

Për këto shkaqe, caktimi i programit të themeluar është fokus i kompletimit të numrit të plotë të gjyqtarëve, por gjithsesi edhe rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësor përmes sigurimit të mjeteve financiare për plotësimin e vendeve të punës te nëpunësit gjyqësor me mungesën e të cilit çdo herë ballafaqohet Gjykata, posaçërisht te kuadri profesional që është fuqia motorike e institucionit.

Rritja e buxhetit për përparimin e sistemit kompjuterik, duke u nisur nga premisa se një investim përkatës në automatizimin e punës drejtpërdrejtë rezulton në përfitim për kuadrin njerëzor.

Në pajtim me nenin 8 nga Rregullorja gjyqësore, një nga kompetencat themelore të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është që të formojë Trupin punues për standardizimin e procedurave në gjykatat, kompetencën themelore e të cilës Rregullorja e definon gjerësisht si përdorim dhe përparim të sistemit kompjuterik të automatizuar për udhëheqjen me lëndët gjyqësore në gjykatat, si dhe të ndjek punën e saj përmes raporteve tremujore, të cilat Trupi punues i dorëzon te Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Trupi punues i këtillë, veç më është në seancë të përhershme në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ngase e njëjta tregon inercinë gjatë mbledhjes dhe punës, gjë që mund t'i atribuohet mbingarkesës së anëtarëve me detyra tjera, por edhe me koordinim të dobët me gjykatat më të ulëta që e pengojnë rrjedhën e informacioneve për problemet dhe vështirësitë reale në sistemin kompjuterik dhe menaxhimin me lëndët. Është i domosdoshëm përforcimi dhe ringjallja e punës së këtij organi, i cili ka potencial të konsiderueshëm për rritjen e efikasitetit në menaxhimin me lëndët gjyqësore.

Duke pasur parasysh Pandeminë e shkaktuar nga virusi korona është e domosdoshme që në fokusin e qëllimeve të programit të sigurohet zhvillimi i mjeteve elektronike për këshillim, mbledhje dhe vendimmarrje nga larg, me çka do të mundësohet puna papengesë e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kohë të kushteve të jashtëzakonshme si dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e njerëzve.

Një nga qëllimet themelore të programit është përforcimi i pozitës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në komunikim me Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrinë e Drejtësisë, që do të arrihet me thellimin e bashkëpunimit me Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes bisedimeve transparente për gjendjen momentale në gjykatat, problemet reale në kryerjen e funksionit të gjyqtarit dhe propozimet për tejkalimin e këtyre problemeve.

Programi i punës së Gjykatës për vitin 2022 hyn në fuqi menjëherë, ndërsa do të zbatohet nga miratimi i saj nga Seanca e përgjithshme.

Programi i punës së Gjykatës gjatë vitit mund të ndryshohet dhe plotësohet në pajtim me ndryshimet dhe rrethanat e krijuara.

**ПРЕТСЕДАТЕЛ НА ВРХОВНИОТ СУД НА РЕПУБЛИКА
СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT**

Besa Ademi